

20130230714

L I G J
PËR NDRYSHIMIN E LIGJIT PËR KULTURË

Neni 1

Në Ligjin për kulturë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 31/98, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/10, 47/11, 51/11 dhe 136/12) neni 43 ndryshon si vijon:

“Në kulturë interesi publik mund të realizohet edhe nëpërmjet koncesionit ose me vendosje të partneritetit privat publik, në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik, e në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore interesi publik realizohet nëpërmjet koncesionit ose me vendosjen e partneritetit privat publik, në pajtim me Ligjin për koncesione dhe partneritet privat publik, në kushte të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore.”

Neni 2

Neni 57 shlyhet.

Neni 3

Titulli “Nënpjesa 2” nëntitulli “EVIDENCA” dhe neni 90 shlyhen.

Neni 4

Në nenet 91 paragrafi 1 alineja 2 dhe 91-a paragrafi 1 alineja 2 shlyhen.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.